

E DUA SEPSE



ËSHTË PJESË E IMJA

NDRYSHIMET TONA NË DEMOKRACI

ELONA (13), MEDINA (14), LORESA (13), ARTA (13), EDUART M. (13), ALTIN (13), EDUART SH. (13),

RINOR (13)



Ne jemi nxënësit e shkollës fillore „Shefki Kuleta“ nga fshati Tërrnavë. Për ju të interesuar lexues, ne kemi përgatitur një artikull informues për demokracinë

Demokracia është paraqitur për herë të parë në Greqinë e lashtë në vitin 507 para erës sonë. Nga kjo gjuhë e ka edhe prejardhjen fjala demokraci. Fjala greke „demos“ do të thotë popull, kurse ajo „kratos“ udhëheqje. Në demokraci ka barazi dhe të drejta të barabarta të qytetarëve, dhe jo vetëm. Disa nga këto të drejta janë: e drejta e të jetuarit, e emrit, e të shprehurit lirshëm, etj. Ne si nxënës të klasës së VIII-të diskutuam edhe për mundësitë tona si të jemi aktiv në demokraci. Njëri nga diskutimet që e zhvilluam ishte lidhur me krijimin e një parku në fshatin tonë. Ne e shpjeguam situatën e tanishme dhe shprehëm disa ide se si ajo pjesë mund të shfrytëzohet më mirë. Gjithashtu, idetë tona ishin të lidhura me atraksionet që ne mund t'i shtojmë fshatit. Do të ishte shumë mirë, po të ekzistonte edhe një vend për bashkëmoshatarët tanë, për t'u zbavitur dhe për t'u shoqëruar në mes vete.

Gjatë punës së sotme, grupi ynë ka punuar në bazë të disa elementeve, të cilat ishin të pranishme edhe këtu, në projektin e Kuvendit të Kosovës „Demos-ti“. Këto



elemente që ne i përdorëm janë elemente të sistemit demokratik. E këto janë, ndër të tjerash: barazia, toleranca, paqja dhe respekti. Ashtu siç edhe vetë fjala demokraci nënkupton, udhëheqja e vendit bëhet nga populli. Në këtë mënyrë edhe ne do të kujdesemi dhe do ta udhëheqim fshatin tonë.



Autorët demokratikë

ZGJEDHIM UDHËHEQËSIT TANË

LULE (13), MEDINA (13), ERJON (13), HASIME (13), BESFORTA (13), ADEM (14), EDON (13), RIAD (13)



Në shoqërinë tonë thuhet se mollëkuqet sjellin fat të mirë. Ashtu është edhe demokracia. Kudo që ka demokraci ka mbarësi

Unë Besforta dhe miku im Riadi, jemi miq të ngushtë tash e disa vjet. Madje, të dytë jemi të lindur në të njëjtin vit. Kjo nënkupton se të dy, në të njëjtin vit, do të arrijmë moshën 18 vjeçare. Ky fakt na gëzon tej mase, sepse do të kemi mundësi të marrim pjesë për herë të parë në procesin zgjedhor, po në të njëjtën kohë. Pavarësisht shoqërisë sonë të mirë, ne jemi të vetëdijshëm se kur të vie koha të votojmë, ne nuk do t'ia imponojmë njëri-tjetrit zgjedhjen. Për shembull, nëse mua më pëlqen partia „Ylberi“, ndërkaq Riadit partia „Shiu“. Por, kjo nuk do të thotë se ne duhet ta votojmë të njëjtën parti.


Përkundrazi, ne respektojmë mendimin e njëri-tjetrit dhe e vazhdojmë shoqërinë tonë si gjithmonë.

E morëm këtë shembull në mënyrë që ju, lexues të artikullit tonë, ta kuptoni se vota është e pavarur dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të imponohet nga askush. Edhe pse unë dhe Riadi jemi të ndryshëm për nga gjinia, kjo nuk i jep asnjërit prej neve më shumë të drejta sesa tjetrit. Ky sistem i qeverisjes, nuk lejon që dikush të gëzojë më shumë të drejta sesa tjetri. Këtu përfshihet edhe procesi zgjedhor. Ky proces është procesi më i rëndësishëm demokratik. A e dini pse? Në këtë proces, qytetarët zgjedhin personat të cilët do ta udhëheqin vendin e tyre. Gjithçka që ata vendosin do të ndikojë në shtetin dhe në jetën tonë si qytetarë. Prandaj, ky proces është kaq i rëndësishëm. Për të ditur se kush e meriton votën tonë, ne duhet të përcjellim fushatat zgjedhore.

Fushatat zgjedhore mbahen pak para procesit zgjedhor. Gjatë kësaj kohe, kandidatët shpalosin planprograme të tyre. Përmes këtyre planprogrameve, ata tregojnë se si do të udhëheqin me vendin. Kështu ne e kemi më të lehtë ta dijim se cili kandidat është i preferuari ynë. Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve. Janë zgjedhjet qendrore, ku qytetarët zgjedhin deputetët, si dhe zgjedhjet komunale, ku qytetarët zgjedhin kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblastët. Të drejtën e votës e gëzojnë vetëm qytetarët, të cilët jetojnë në demokraci. Vota është fuqia që kemi. Pse të mos e shfrytëzojmë atë? Le të jemi pjesë e vendimmarrjes.



Sot ishim gazetarë të Kuvendit. Ky rol aq sa edhe na nderoi, aq na mbushi me përgjegjësi




Zgjedhje bëjmë çdo ditë. Secili ka një ngjyrë të caktuar më të preferuar se tjetrën. Kjo është zgjedhje e përditshme

NJË VOTË E JUAJ, NJË KOSOVË MË E GJELBËR

ALTIN (13), BLERTA (13), KIMETE (13), ERONA (13), VJOLLCA (13), RREZON (13), RIONA (13),

ALAUDIN (13)

Grupi ynë sot ka pasur rastin dhe kënaqësinë të bisedoj dhe të mësoj për tema shumë të rëndësishme. Pas gjithë asaj që mësuam, pretenduam që kemi formuar një parti politike me fokus ruajtjen e ambientit. Se çka mësuam konkretisht dhe cili ishte qëllimi i formimit të kësaj partie, lexojeni artikullin në vijim



„Partia e Gjelbër“ ka fokus mirëqenien e qytetarëve

„Demokracia fillon me çdo njeri“. Kjo është motoja e partisë sonë, ku të gjithë jemi njëzëri dhe veprojmë drejt qëllimeve që ne i kemi vënë partisë. Ajo për çka ne thirrremi është ambienti dhe shëndeti. Çdo gjë është e mundur kur gëzon shëndet të mirë, e shëndetin e mirë e gëzojmë kur ambienti është i pastër. Për këtë arsye, emri i partisë sonë është „Partia e Gjelbër“. Ashtu si partia jonë që synim kryesor ka ambientin dhe punon për t'i arritur qëllimet e veta, ka edhe parti të tjera që kanë të tjera fokuse. Qëllimi ynë kryesor është mirëqenia e qytetarëve.

Vendi ynë është vend që ka udhëheqje demokratike. Nga kjo nënkuptojmë që kemi edhe pluralizëm të etniciteteve, të partive politike, etj. Për partinë tonë, kjo gjë është shumë e mirë, sepse sa më i madh numri i partive politike, aq më e madhe është konkurrenca mes partive politike. Kur ka konkurrencë, secila parti



Mirëqenia arrihet me punë dhe përkushtim, siç vepruam ne

mundohet që të punoj më shumë dhe të fitoj besimin e qytetarëve. Ne deshëm që përmes partisë sonë t'iu tregojmë që çdo qytetar, i cili është pjesë e ndonjë partie politike, së pari i vë në pah interesat e popullit, pastaj ato që ka partia. Shembull i partisë sonë ishte ndërtimi i një fabrike. Në këtë fabrikë të gjitha mbeturinat që vijnë të ndara për reciklim do të recikloheshin me të vërtetë. Këtë do ta bënim në mënyrë që qytetarët të mos ndihen të zhgënjyer dhe të kenë një vend për reciklim të mbeturinave të tyre. Pra, ne nuk menduam vetëm për veten tonë, por për Kosovën dhe të gjithë qytetarët e saj. Ju të dashur lexues, e dini sa e nevojshme është ndërtimi i kësaj fabrike. Për çdo ditë ne krijojmë të mbetura, të cilave iu duhen mijëra vjet për t'u zbërthyer. Tash mendoni edhe ju, a mund të kemi shëndet të mirë kur e dijme se sa mbeturina janë në ambientet tona publike?




Si partia jonë e simuluar sot, ka shumë parti që funksionojnë dhe janë mjaft aktive në vendin tonë. Por, çka është më e rëndësishme, disa anëtarë të partive edhe janë pjesë e Kuvendit të Kosovës, pra punojnë si deputetë. Qëllimi i tyre është të miratojnë ligje për popullin. Edhe me Kushtetutë është e paraparë që deputetët/et së pari i përfaqësojnë interesat dhe nevojat e popullit, e pastaj ato të partisë. Kështu mendojmë edhe ne. Populli vjen para interesave partiake. Populli është yni, e ne jemi të popullit!

ATY KU VENDOSJET E ARDHMJA JONË

XHEVAT (14), VALMIR (13), ERJON (13), ALBION (13), ADONITA (13), RINESA M. (14), RINESA A. (13),

ALTINA (14)



Ne nxënësit e shkollës së mesme të ulët „Shefki Kuleta“ kemi ardhur për vizitë në organizatën joqeveritare „Toka“. Sot jemi pjesë e projektit „Demos-ti“. Si shkoj dita jonë, vazhdoni leximin

Projekti i lartpërmendur punon në interes të nxënësve, të cilëve u mundëson marrjen e informacioneve të shumta rreth temave të caktuara që lidhen me demokracinë. Pjesa e parë, me të cilën filluam pas ardhjes sonë ishte njoftimi me agjendën e ditës së sotme, e pastaj vazhduam me lojëra argëtuese. Pas lojërave, u ndamë në grupe të vogla dhe filluam punën. Tema me të cilën filluam punën tonë ishte Kuvendi i Kosovës. Për këtë temë, morëm shumë informacione, të cilat nuk i kishim ditur më parë. Këto informacione kemi shumë dëshirë t'i ndajmë me të gjithë juve, të cilët në këto momente keni zgjedhur të lexoni gazetën tonë. Kuvendi i Kosovës përbëhet nga deputetët dhe Kryesia e tij, e cila përbëhet prej Kryetarit të Kuvendit

dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Kuvendi i Kosovës ka gjithsej 120 deputetë. 30% prej tyre sipas Kushtetutës sonë duhet të jenë patjetër gra e 10 duhet të jenë serbë. Kurse, 10 të tjerë duhet të jenë pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme jo shumicë si: boshnjakë, ashkalinjë, romë, egjiptianë, goranë dhe turq. Këta deputetë janë të zgjedhur nga populli dhe ne kemi të drejtë të marrim pjesë në përzgjedhjen e tyre që nga moshë 18 vjeçare. Fjala „Kuvend“ ka kuptimin e njëjtë me fjalën „Parlament“. Prandaj, zgjedhjet ku votojmë deputetët quhen zgjedhje parlamentare.

Ne sot kishim fatin të hyjmë brenda në Kuvendin e Kosovës dhe pamë sallën e seancave plenare. Aty vërejtëm se ishin 3 kolona të gjata me ulëse. Në ato ulëse uleshin deputetët. Në kolonën qendrore, uleshin deputetët të cilët kishin marrë më së shumti vota, në anën e djathtë uleshin deputetët e partisë së dytë më të madhe. Kurse, në anën e majtë uleshin deputetët opozitarë, apo të partisë më pak të votuar sesa të tjerat. Roli i Kuvendit është shumë i madh, sepse deputetët miratojnë ligjet në emrin tonë. E ne si qytetarë duhet t'i respektojmë patjetër ato. Sot kishim një rast të veçantë. Rugës duke ardhur në „Demos-ti“ tërhoqëm vëmendjen e shoferit të autobusit, duke i thënë se ai duhej të kishte shumë kujdes gjatë vozitjes së autobusit dhe të respektonte të gjitha shenjat e komunikacionit. Ai e bëri këtë, sepse respektimi i ligjeve është gjithmonë i nevojshëm dhe këtë iu ftojmë ta bëni edhe ju!



E ardhmja e vendit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Shefki Kuleta“
Klasa: VIII-1
Vendi: Tërrnavë, Podujevë